



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AAB CONSTRUCTION Sh.P.K." të datës 27.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AAB CONSTRUCTION Sh.P.K." të datës 27.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AAB CONSTRUCTION Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 27.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

“Në rastin konkret, ne kemi ofruar zgjatjen e vlefshmërisë së sigurimit të tenderit në afatin 125-ditësh, sipas dokumentit të sigurimit të dorëzuar. Në rastin konkret, kërkesa nuk është përmbushur sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues (AK). Si e tillë, AK është dashur ta eliminojë kompaninë dhe të mos e favorizojë për shpallje si të përgjegjshme. E gjithë kjo është në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Ky veprim i Autoritetit Kontraktues përbën shkelje pasi është bërë favorizim i padrejtë ndaj një operatori të caktuar dhe është cenuar parimi i barazisë dhe transparencës në procesin e prokurimit. Nga verifikimi ynë, kemi konstatuar se nuk është prezantuar asnjë dokument i tillë për drejtuesin tjetër të kompanisë, z. Arbnor Alidema, por vetëm për njërin nga pronarët, z. Enis Alidemi. Duke marrë parasysh që dokumentet e tilla janë të detyrueshme dhe kërkesa e Autoritetit Kontraktues është shumë e qartë, pasi përcakton se ky vërtetim duhet të jetë për çdo drejtues, menaxher ose drejtor të operatorit ekonomik, Autoriteti Kontraktues është dashur ta eliminojë këtë operator nga procedura, meqenëse nuk ka përmbushur kërkesën e detyrueshme të dosjes së tenderit. Për këtë pozitë, është angazhuar Ing. Shaqir Idrizi, si dëshmi për të cilin është paraqitur një Letër Reference nga kompania Electra SHPK. Megjithatë, angazhimi i tij në këtë kompani nuk është evidentuar në CV. Po ashtu, është paraqitur edhe një Letër Reference nga kompania Developing Together, e cila gjithashtu nuk është e evidentuar në CV. Ndërsa në Letrën e Referencës nga Pro&Co Group, janë prezantuar projekte që nuk janë pjesë e përvojës së evidentuar në CV. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur, rezultohet se kërkesa për këtë pozitë nuk është përmbushur. Për këtë pozitë është angazhuar Ing. Alban Morina, i diplomuar më 20.03.2019. Si dëshmi për përvojën e punës, është paraqitur një Letër Reference nga organizata CHWB, mirëpo kjo referencë nuk e përmbush kërkesën për së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Gjithashtu, është paraqitur edhe një Letër Reference e lëshuar nga vet kompania ofertues – EuroCommerce, megjithatë në CV-në e inxhinierit nuk figuron që ai të ketë qenë ndonjëherë i angazhuar në këtë kompani. Edhe nëse merret një analizë e detajuar e referencës së lëshuar nga EuroCommerce, në të janë të listuara projekte të viteve që nuk përmbushin kërkesën për përvojë pune trevjeçare pas diplomimit. Për shembull, projekti “Restaurimi i Muzeut Komunal” (periudha 16.01.2020 – 20.03.2020) është një projekt në të cilin Ing. Morina ka qenë i angazhuar nga Autoriteti Kontraktues – CHWB, në cilësinë e mbikëqyrësit të projektit, dhe jo nga kompania EuroCommerce. Prandaj, EuroCommerce nuk mund të lëshojë referencë për një staf i cili nuk ka qenë i angazhuar nga ana e saj në këtë projekt. Nga analiza e mësipërme rezulton se referenca e paraqitur është e pabazë (fiktive) dhe rrjedhimisht, kërkesa për këtë pozitë nuk është përmbushur. Për kërkesën në fjalë është prezantuar autobetoniere mikser, mirëpo kjo pajisje shërben vetëm për transportin e betonit, ndërsa kërkesa e dosjes është që automikseri të jetë për prodhimin e betonit. OE ka prezantuar një autobetoniere mikser, e cila përdoret për transportin e betonit të gatshëm nga impianti në vendpunishte. Ndërkohë, kërkesa në dosje është një automikser për prodhimin e betonit, që do të thotë njësi e pajisur me system për përzierje dhe prodhim të betonit në vend, jo vetëm për transport. Pra, pajisja e ofruar nuk përmbush kërkesën teknike të përcaktuar në dosje, pasi nuk është për prodhim, por vetëm për transport të betonit. Të bashkangjitur e gjeni paisjen tonë e cila e përmbush kërkesën. Paisja e prezantuar nga ana e kompanisë të shpallur nga ana juaj si e përgjegjshme e cila nuk e përmbush kërkesën. Paisja e prezantuar nga ana jone-automikser për prodhimin e betonit-e cila bene prodhimin e betonit në punishte-e cila edhe e përmbush kërkesën tuaj.”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.11.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.